



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS

01. NR. 06-3986/15
KLINË, 29. 5.2015

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT
I SEANCËS SË V-te E RREGULLT PËR VITIN 2015, E KK MBAJTUR MË 29.5.2015,
NË ORËN 10.00, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e KK, drejtorët e ekzekutivit, Zyra ligjore, OSBE, Zyra e Auditimit, OJQ-të, mediet etj.

Seancën e hapi kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të AK.

Në vijim kryesuesi njoftoi anëtarët e KK lidhur me vendimin e Ministrisë rreth pezullimit të vendimit lidhur me pronat e Komunës të lëshuara për Kishën Katolike shqiptare në Deiq, po ashtu edhe rreth xhamisë në Këpuz. Kryesuesi sqaroi që për këto dy çështje do të debatohet në seancën e radhës të KK, përkatësisht të qershorit.

Në vazhdim kryesuesi fjalën ia dha anëtarit Bozhidar Sharkoviq.

Bozhidar Sharkoviq, foli rreth gjendjes së sigurisë në Komunën e Klinës, përkatësisht rreth disa rasteve të grabitjeve dhe sulmeve fizike që kanë ndodhur nga persona të papërgjegjshëm ndaj individëve dhe pronave të komunitetit serb.

Enver Berisha, foli për shqetësimet e anëtarit, z. Sharkoviq, për rastet e potencuar, po ashtu nënkryetari Berisha sqaroi angazhimin e strukturave komunale në bashkëpunim me policinë e Klinës dhe atë rajonale, po ashtu edhe me Ministrinë për Kthim, me qëllim të krijimit të një klime të favorshme të sigurisë, jo vetëm për komunitetin pakicë serb, por për të gjitha komunitetet që jetojnë në Komunën e Klinës. Sipas nënkryetari Berisha strukturat komunale të Klinës i janë mirënjohës policisë në Klinë dhe asaj rajonale për angazhimin edhe efikasitetin në gjetjen e akterëve të këtyre rasteve, të cilat raste nuk kanë motive të caktuara politike, por kryesisht janë vepra që i kanë kryer element keqbërës, të cilët janë të prirë për veprime të tilla për t'u shkaktuar gjithë qytetarëve të të gjitha komuniteteve, jo vetëm atij serb.

Vlora Tafilaj, tha se nuk duhet të na brengosin këto raste, sepse kemi informacione se shkaktarë të këtyre rasteve janë kryesisht këta vetë.

Skënder Merturi, tha se më vjen keq që Kryetari nuk gjendet momentalisht këtu, desha të shtroj dy pyetje: meqenëse pyetjet janë të lidhur me te: Pse kryetari ka qenë jashtë vendit dhe pse seancat e KK nuk po transmetohen drejtpërdrejt në Radio Alba?

Haxhi Ibishi, në emër të KK dënoi rastet e fundit të sulmeve dhe grabitjeve të pronave serbe. Në vijim kryesuesi Ibishi kërkoi që këto raste të mos reflektojnë në klimën për të cilën është punuar në Komunën e Klinës. Kryesuesi po ashtu kërkoi nga organet e policisë dhe të tjera kompetente që të gjitha aktet të ndriçohen.

Kryesuesi vuri në miratim pikat e rendit të ditës.

Me vota unanime u miratua ky

RENDI I DITËS:

1. Arsyetimi i mungesave
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga séance e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për vënien në diskutim publik të Raportit të Komisionit për implementimin e programit të hartuar nga Komisioni European për sistemin e adresave në territorin e KK – për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në qytet dhe fshatra,
4. Njoftim me Qarkoren buxhetore për vitin 2016 në Komunë (Nga Drejtoria FEZH).

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi që asnjë anëtar nuk mungon në këtë seancë.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi sqaroi që seanca e kaluar ka përfunduar sot, prandaj sugjeroi që këta procesverbale të shqyrtohen dhe analizohen në seancën e radhës.

Anëtarët u pajtuan me këtë propozim të Kryesuesit.

Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për vënien në diskutim publik të Raportit të Komisionit për implementimin e programit të hartuar nga Komisioni European për sistemin e adresave në territorin e KK – për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në qytet dhe fshatra.

Zeqir Morina, kryetar i Komisionit për implementimin e programit të hartuar nga Komisioni European për sistemin e adresave në territorin e KK – për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në

qytet dhe fshatra, raportoi në mënyrë kronologjike rreth punës së bërë në terren rreth këtij komisioni.

Bajrush Shala, sqaroi dy gabime teknike që janë të lëshuar në këtë raport: në numrin 293 ku shkruan “Shën Domi”, duhet të jetë “Shën Gjoni” dhe në numrin 360, në vend të emrit “Kolë Gojani” duhet të jetë “Martirët e Gjinajve”, sqaroi Shala.

Fadil Gashi, tha se e kemi debatuar edhe në KPF dhe nuk e shoh të arsyeshme që rreth kësaj çështjeje për ta zgjatur. “Ta kemi një sqarim të përbashkët. Është obligative për të dalë në diskutim publik. Komisioni ka kryer punën e vet”, shtoi anëtar Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se duhet respektuar të gjitha aktet normative.

Ndue Shabanaj, tha se të gjitha propozimet që kanë ardhur nga fshatrat të përfshihen në listë. “Komisioni është i obliguar që listën e propozuar si tërësi t’ia prezantojë Kuvendit”.

Lorenc Marleku, tha se nuk duhet të jetë listë përfundimtare kjo që po na prezantohet këtu.

Haxhi Ibishi, tha se komisioni ka bërë punë të madhe, është punë tepër e mundimshme. “Do të jetë debate me publikun, kur të gjithë do të debatojnë. Kisha pasur të arsyeshme që ta vejmë në propozimin për debatin me publikun”.

Prend Buzhala, tha se thjesht po vërej punën e komisionit. “Është një shqetësim. Komuna e Klinës është vonuar me vendosjen e tabelave, ndërsa komunat tjera i kanë vendosur. Të kenë kujdes edhe te drejtshkrimet, të mos deformohen emërtimet duke mos përfillur drejtshkrimin. Kam dëshirë të jem pjesë e debatit. 20 rrugë po dalin rrugë të fshatit Dresnik. Aty ka edhe banorë serbë, nuk po dua t’u dal në mbrojtje, a ka edhe ndonjë rrugë të emërtuar nga ai komunitet. Dhe, ndërsa janë gjitha këto rrugë të fshatit Dresnik, a janë pyetur banorët e këtij fshati rreth emërtimit të këtyre rrugëve”, shtoi prof. Buzhala.

Bozhidar Sharkoviq, shtroi pyetjen: kur pritet për t’u bërë debate me publikun?

Haxhi Ibishi, sqaroi që për debatin me publikun të gjithë qytetarët e komunës së Klinës do të njoftohen me kohë rreth debatit me publikun.

Kryesuesi vuri në miratim raportin për vënien në diskutim publik.

Me vota unanime u miratua propozimi për vënien në diskutim publik të raportit të komisionit për implementimin e programit të hartuar nga Komisioni Europian për sistemin e adresave në territorin e KK – për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në qytet dhe fshatra.

Pika e katërt: Njoftim me Qarkoren buxhetore për vitin 2016 në Komunë (Nga Drejtoria FEZH).

Ramiz Rrusta, drejtor i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, në mënyrë kronologjike raportoi rreth Qarkores buxhetore për vitin 2016 në Komunën. “Deri më 5 qershor duhet të bëhet rishikimi i buxhetit. “Kjo datë është afati i fundit, prandaj kemi për obligim që ta miratojmë dhe eta përcjellim”, shtoi drejtori Rrusta.

Prend Buzhala, theksoi se desha ta prezantoj një shqetësim të banorëve të fshatit Dobërdol: fshati Dobërdol, përkatësisht disa përfaqësues të këtij fshati kanë deklaruar se kanë dhënë 30 mijë euro për asfaltimin e rrugës së fshatit. “Thonë se Komuna ka shpallur tender, mirëpo punimet nuk kanë filluar. Dhe një çështje tjetër shqetësuese: Pse banorët e disa lokaliteteve paguajnë, ndërsa disa jo, pse bëhet ky dallim?”- pyeti prof. Buzhala.

Sokol Bashota, sqaroi çsthjen e ngritur nga anëtari Buzhala. “Rruga e Dobërdolit ka dalë në tenderim, janë marrë zotimet. Pyetja e parashtruar, pse disa paguajnë disa jo, ju sqaroj se ne e kemi dhënë vlerën e përqindjes që ata banorë që participojnë të keni përparësi në realizimin e projekteve. Pra, ata që kanë gatishmërinë për të participuar ne ju japim përparësi në realizimin e projekteve. Kjo është arsyeja , vetëm te gatishmëria e qytetarëve për të participuar në projektet”, sqaroi kryetari Bashota.

Tunë Dedaj, pyeti kryetarin Bashota që kur do të vjen në fshatin Deiq që të njoftohet me hallet e qytetarëve. “Fshati Deiq, i cili është këtu shumë afër as 2 kilometra është fshati që më së paku ka përfituar në realizimin e projekteve. Rruga e asfaltuar ka mbetur përgjysmë, që nuk ka arritur të shtrihet deri ku do të duhej të ishte”, tha Dedaj.

Avni Gashi, tha se kam vërejtje, sepse sapo na erdhi dokumenti dhe nuk është serioze për të diskutuar rreth tij.

Arben Limani, tha se derisa po në servohen gjerat ne si grup parlamentar i LDK-së nuk do ta votojmë.

Ramiz Rrusta, sqaroi çështjen e dokumentit. “Shkresa është ardhur më 21 maj. Kemi punuar në mënyrë intensive për ta përgatitur. Për vonesën nuk është faji yni, është i Ministrisë përkatëse. Ne e kemi punuar me një përkushtim të jashtëzakonshëm dhe ju kemi sjellë përpara. Ju ftoj që ta votoni se kemi datën e fundit të caktuar”.

Haxhi Ibishi, tha se kërkoj mirëkuptimin tuaj. “Drejtorja jonë iu ka ofruar dokumentin jo me kohë, dhe iu ka ardhur realisht me vonesë, megjithatë janë afatet e dorëzimit. Mirëkuptimi ka ndodhur. Kërkoj nga partitë për të reflektuar.

Skënder Merturi, tha se nuk po mund për ta kuptuar pse bëhet kalldrëmi i rrugës në qytet. “Më mirë le të jetë asfaltimi i rrugës se sa kalldrëmi, sepse edhe ashtu kalldrëmi kërkon një investim shumë më të madh. Për mua është e pakuptueshme kjo”, tha ai.

Fadil Gashi, prezantoi disa sqarime rreth çështjes në debat. “Ne emër të GP të LDK-së sqarimin edhe Arbeni, unë vetëm po e plotësoj. “Kemi një dokument pa asnjë titull. Nuk kemi të bëjmë

me një rishikim të thjeshtë por kemi të bëjmë me 188000 mije euro. Këto mjete i ka menaxhuar Komuna. Nuk janë fajet gjithherë atje, në ministri”, shtoi ndër të tjera anëtari Gashi.

Sokol Bashota, foli rreth çështjes në shqyrtim. “Ekziston logoja e Komunës, e cila duhet të vihet në cilindo dokument të Komunës, megjithatë këtu mungon. Te projekti ku shkruan “asfaltimi i rrugës në qytet, kodi 90075”, është lëshuar gabim teknik, sepse në vend të shprehjes “asfaltimi” duhet të jetë “kubëzimi”. Pra, duhet të jetë, “kubëzimi i rrugës në qytet, kodi 90075”. Po ashtu, vazhdoi Kryetari, disa projekte kanë qenë në vijimësi. Disa rrugë, si e Përqevës, Siqevës dhe e Dushit, me 100 mijë euro nuk mbulohen këto investime. Me qëllimin më të mirë nuk është kthyer ky suficit në Qeverinë e Kosovës. Kemi pasur rastin kur kemi thirrur seancë të jashtëzakonshme për këtë qëllim. Defekti, pikërisht qëndron te Ministria kjo na ka përcjellë sa e sa vite. Këto mjete janë paraparë mbi bazën e rishikimeve buxhetore për këto fshatra, mirëpo kjo duhet të jetë me vendim të kuvendit”, sqaroi kryetari Bashota.

Rasim Millaku, tha se kemi projektin që është lënë përgjysmë, urën e lagjes Mustafaj. “Në rishikimin e buxhetit është dashur të jetë edhe ky projekt. Projektet të kanalizohen mirë. Kërkoj që në bazë të rishikimit të buxhetit të rregullohet edhe kjo urë”.

Ramiz Rrusta, edhe një herë sqaroi çështjen e vonesës së shkresës, por edhe arsyeshmërinë pse dokumenti duhet të votohet. “Kemi afatin, me 5 qershor është afati, ju kisha kërkuar mirëkuptim që ta votoni dokumentin, pra të votohet nga ju rishikimi i buxhetit”, tha drejtori Rrusta.


Kryesuesi vuri në miratim rishikimin e buxhetit për vitin 2015.

Me 14 vota për, 12 kundër u miratua rishikimi i buxhetit për vitin 2015.

Kryesuesi Ibishi seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 15.05 minuta.

Procesmbajtësi,
Mikel Gojani



Kryesuesi i Kuvendit,
Dr. Haxhi Ibishi